



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Paulin Sterkaj, Luan Duzha, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Elena Xhina, Adnor Shameti, Anduel Xhindi dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Milva Ekonomi, Xhemal Qefalia, Myslim Murrizi dhe Pjerin Ndreu.

Të ftuar:

Alfred Progonati – prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme

Kujtim Luli - përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Faleminderit për prezencën!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Rendi i ditës së kësaj mbledhjeje është shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Dje kemi bërë miratimin në parim të këtij projektligji dhe sot mendojmë të fillojmë diskutimin nen për nen. Shpresoj që do të kemi një ecuri të mirë të diskutimit, ndërkohë që ligji është planifikuar për javën që vjen të kalojë në seancën plenare.

Ashtu si edhe dje, të ftuar kemi dy prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, zotin Kujtim Luli dhe zotin Alfred Progonati. Mirë se erdhët!

Nga Kuvendi i Shqipërisë kemi zonjën Mimoza Arbri, drejtoreshën Juridike.

Ftoj kolegët që të fillojmë me diskutimin nen për nen.

Për lehtësi pune, ju sugjeroj që të punojmë me tabelën si ka qenë projekti dorëzuar në momentin fillestar në Kuvendin e Shqipërisë dhe si është projekti i definuar nga grupi i punës, që është marrë me projektin më herët dhe është marrë për një kohë relativisht jo të vogël.

Atëherë, fillojmë ne nenin 1 të projektit, i cili bën fjalë për “Objektin”.

Në këtë nen përcaktohen rregullat dhe parimet e përgjithshme, që i takojnë organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të seksioneve të Policisë Gjyqësore, veprimtarisë hetimore, statusit të oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe raporteve që Policia e Gjyqësore do të ketë me prokurorinë, po ashtu edhe me institucionet e tjera shtetërore.

A ka ndonjë vërejtje të tjera nga kolegët për nenin 1?

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2 “Përkufizimet”.

Përpara se ta miratojmë këtë nen, dua të dëgjoj nga kolegët nëse ka ndonjë sugjerim për ndonjërin nga 9 pikat, të cilat përmbajnë përkufizimet e termave që përdor projektligji në fjalë.

Atëherë, po bëj unë një sugjerim, në fakt, sugjerimin e kam për pikën 5 “për papajtueshmërinë etike”. Dua të marr opinionin e dy prokurorëve, nëse ky është termi i përshtatshëm për t’u përdorur. Personalisht gjykoj se nuk është term me vend “papajtueshmëria etike”, nuk është aq e rëndë sa papajtueshmëria thelbësore dhe të qenit në konflikt interesi të oficerëve të Policisë Gjyqësore me rastin që janë duke hetuar është papajtueshmëri thelbësore. Propozoj që ta lëmë thjesht “papajtueshmëria” dhe jo t’i vendosim pas përcaktimin “etike”. Ka

kod etike prokuroria, oficerët e Policisë Gjyqësore mbajnë përgjegjësi, sipas kodit të etikës dhe sipas komisioneve të etikës që ngrihen.

Gjithsesi, dua të t'ju dëgjoj para se sa të vendosim për këtë.

Urdhëroni, zoti Luli!

Kujtim Luli – Faleminderit, zonja kryetare!

Termi “papajtueshmëria etike” është një term i diskutueshëm, i cili nuk gjendet në kuadrin ligjor të sistemit gjyqësor. Është e vërtetë që ne përdorim termin “papajtueshmëri”, por “papajtueshmërinë” gjithmonë e lidhim me dispozitat përkatëse të neneve 16 dhe 17, aty janë rastet e papajtueshmërisë edhe për oficerët e Policisë Gjyqësore, “papajtueshmëria”, referuar nenit 27, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, ata duhet të sillen si prokurori. Në rastet e papajtueshmërisë është edhe dispozita e nenit 19 në draft: ku thotë: “heqja dorë dhe zëvendësimi”. Pra, “për heqjen dorë dhe zëvendësimin e oficerit të Policisë gjyqësore, projektligji parashikon që të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pra, një referencë e këtij neni të projektligjit është neni 27 i Kodit të Procedurës Penale. Kështu që, nëse ne do të trajtojmë papajtueshmërinë me termat e vendosur në pjesën arsyetuese të kësaj pike, për mua ajo që lidhet me gjënë familjare është e papajtueshme në formulimin e këtij neni, sepse “papajtueshmëri etike” ose “shkelje etike” që lidhet me gjendjen familjare, nuk ka sens, por shkelet etika në lidhje me konfliktin e interesit dhe në një lidhje shoqërore të papërshtatshme kanë sens. Kështu që, nëse do ta lëmë “Shkelje etike” ose “Papajtueshmëri etike” mund ta diskutojmë, por mua nuk më duket term i gjetur “Papajtueshmëria etike”. Unë mendoj ta quajmë “shkelje etike”.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Unë mendoj që ta heqim fjalën “etike” dhe të rrijë “papajtueshmëria” ose “papajtueshmëri” dhe në këtë të mënyrë nuk mund t’ia lidhim këmbët vetes, sepse rastet që mund të përbëjnë papajtueshmëri nuk janë në një listë shteruese, praktika mund të identifikojë raste nga më të ndryshmet, por duke i vendosur përcaktimin do të lind diskutimi nëse është etike apo jo kur ajo mund të jetë haptazi ligjore, që ka konflikt me ligjin, ku në këtë rast është ai që sapo ju referuat, Kodi i Procedurës Penale, i cili të orienton për rastet e papajtueshmërisë. Kështu që është më e gjerë dhe nuk mund të krijojë problem po të jetë i tillë.

Atëherë, a jeni dakord që të hiqet fjala “etike” nga pika 5 e nenit 2?

Elena Xhina – Nëse e heqim termin “etik”, duhet të themi “papajtueshmëria në kuptim të këtij ligji është një situatë...”. Pra, përpara fjalës “është një situatë” të vendosim fjalën “në kuptim të këtij ligji” dhe të mos përzihemi me kuptimet që jep Kodi i Procedurës Penale.

Pra, nëse heqim fjalën “etikë”, duhet të themi “papajtueshmëri në kuptim të këtij ligji është një situatë kur oficeri i policisë...”

Ermonela Felaj – Mund ta themi edhe direkt duke hequr fjalët “është një” dhe ta lëmë “situata kur oficeri i policisë...”

Elena Xhina- E kuptoj, por për të mos u konfunduar me rastet e tjera të papajtueshmërive që parashikojnë legjislacionet e tjera. Megjithatë e propozon...

Ermonela Felaj –Atëherë, jemi dakord që fjala “etike” të hiqet dhe të reflektohet formulimi sipas propozimit të zonjës Elena Xhina. Kush është dakord me nenin 2 me ndryshimin e bërë në pikën 5? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 3 “Parimet në ushtrimin e veprimtarisë së Policisë Gjyqësore”. Këto, në fakt, janë parime që përdoren në ligje të ngjashme dhe normojnë edhe veprimin e të gjithë Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të saj ose kontributeve që ky ligj jep. A ka vërejtje për nenin 3? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 4, i cili parashikon subjekte që ushtrojnë funksione të Policisë Gjyqësore. Ashtu siç folëm edhe dje, këto subjekte do të jenë oficerët e Policisë Gjyqësore të seksioneve, që janë pjesë e prokurorive të shkallës së parë, të Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, janë punonjësit e Policisë së Shtetit, që kanë atributet e Policisë Gjyqësore, natyrisht është Byroja Kombëtar e Hetimit, sepse është strukturë e Policisë Gjyqësore, ashtu siç përcaktohet edhe në ligjin për organet e posaçme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe punonjësit e shërbimeve të tjera policore dhe institucionet shtetërore, ku përmendim tatimet, doganat dhe punonjësit e Policisë Ushtarake, të cilët marrin attribute nga ky ligj dhe ushtrojnë funksione njësoj si Policia Gjyqësore.

Po, zoti Luli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë edhe agjentët pjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, e kuptoj.

Në fakt, agjentët e Policisë Gjyqësore janë inspektorët e zonave ose STZ-të (specialistët e zonave), që e mbulon germa “ç”.

Kujtim Luli – Jo, te germa “ç” Kodi i Procedurës Penale përcakton terminologji fikse, janë hetuesit e BKH-së. Në nenin 30, pika 2, është në mënyrë eksplicite emërtimi, të cilin e përshtatim edhe me dispozitën përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

Ermonela Felaj – Atëherë, për efekt regjistrimi, ideja është që te germa “b” të reflektohet një ndryshim duke thënë “Oficerët e shërbimeve të Policisë së Shtetit” dhe te germa “c” të thuhet: ‘Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit’. A ka ndonjë gjë tjetër lidhur me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë thashë edhe unë, që germa “b” të bëhet “Oficerët e shërbimeve të Policisë së Shtetit” dhe germa “c” “Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit”, ndërsa pjesa tjetër të mbetet siç është. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 5 i projektligjit, i cili ka të bëjë me funksionet që ushtron Policia Gjyqësore. Në fakt, ky është një transpozim fjalë për fjalë i asaj që Kodi i Procedurës Penale thotë për Policinë Gjyqësore në tri nenet që i ka dedikuar Policisë Gjyqësore, 30, 31, 32.

A ka ndërhyrje?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Mua më bën përshtypje titulli “Varësia dhe ushtrimi i funksioneve”. Këtu nuk bëhet fjalë për varësi. Unë nuk e kam ngritur si çështje në komision, por konstatoj se është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është kreu. Atëherë, e lëmë kreun, se është në rregull.

Edhe formulimet, siç u tha edhe dje në diskutimin në parimin, kanë nevojë për t’u përmirësuar. Për shembull, germa “a” duhet të përmirësohet. Reformulimi që sugjeroj është: “Me iniciativën e vet ose mbi kallëzimin penal apo ankimin e viktimës duhet të marrë dijeni për veprat, brenda kompetencave të caktuara”. Pra, duhet të shtohet edhe kjo pjesa e kompetencës, sepse, duke qenë se kompetencat e prokurorive janë të ndara midis tyre, edhe një shërbim i policisë, një oficer i Policisë Gjyqësore duhet të zbatojë urdhërimet e gjykatave dhe të prokurorive përkatëse në raport me vendimet gjyqësore përkatëse.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë sugjerim tjetër nga kolegët, apo nga paneli?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Mendoj se dispozita është në rregull, pasi, siç thatë edhe ju, pasqyrohen të njëjtat detyra dhe kompetenca që punonjësit e Policisë Gjyqësore kanë në Kodin e Procedurës Penale. Për më tepër, në projektligj pasqyrohen edhe rastet kur oficerët e Policisë Gjyqësore marrin detyra nga gjykata apo nga prokuroria. Pra, nuk mendoj se ka nevojë për

shtesa të tilla, pasi kompetencat bazë oficerët e Policisë Gjyqësore i marrin nga Kodi i Procedurës Penale dhe nuk i marrin nga ky ligj. Në përgjithësi tregohen detyrat që ushtrojnë në varësi të funksionit të tyre.

Ermonela Felaj – Zoti Luli, në fakt, unë jam dakord me një pjesë të sugjerimit që, në vend të fjalës “nisma”, të vihet fjala “iniciativë”, sepse kjo fjalë përdoret edhe te Kodi i Procedurës Penale. Nuk janë sinonime gjithmonë këto fjalë.

E dyta, nuk jam dakord me shtimin e pjesës “sipas kompetencës”, sepse ndonjëherë konstatimi i kompetencës nuk lind që në momentin e parë. Ne u kemi dhënë të drejtë me ligj që punonjësit e Policisë Gjyqësore të veprojnë dhe të ushtrojnë atributet e tyre edhe kur janë jashtë orarit të punës, edhe kur konstatojnë një veprë penale në territorin, në të cilin ata nuk i ushtrojnë funksionet e tyre, pra ata bëjnë veprimet e para për sigurimin e vendit të ngjarjes, për sigurimin e provave në vendin e ngjarjes, më pas është prokuroria ajo që vendos nëse është kompetente për çështjen apo jo. Kështu që mendoj të mos e ngarkojmë, por të mbetemi edhe në ato përkufizime, që thotë edhe pika 1 e nenit 30 të Kodit të Procedurës Penale: “Policia gjyqësore edhe me iniciativën e saj duhet të marrë dijeni për veprat penale; (ne e kemi të reflektuar këtë në pikën e parë); të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme; të kërkojë autorët e tyre; të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të hetimit penal”. Në pikën 2 të këtij neni thuhet: ‘Policia Gjyqësore kryen çdo veprim hetimor që është urdhëruar ose deleguar nga prokurori’. Te germa “d” ne kemi thënë organi procedues dhe jo prokuroria, pavarësisht se ne me organ procedues nënkuptojmë edhe prokurorinë, edhe gjykatën, sipas rastit.

Kujtim Luli – Referenca që unë shtova lidhur me kompetencën vjen nga neni 277/1 i Kodit të Procedurës Penale, i cili e ka theksuar me ndryshimet e reja që kanë hyrë në fuqi më 1 gusht të vitit 2017. Prandaj mendova ta plotësonim për ta qartësuar që në këtë ligj dhe për të qenë më mirë në vëmendje të oficerëve kur ushtrojnë funksionin.

Ermonela Felaj – Mund ta lexojmë nenin 277 edhe për kolegët: “Prokurori dhe Policia Gjyqësore zhvillojnë brenda kompetencave të caktuara hetime të nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale”. Kam përshtypjen se kjo është për një fazë pak më të vonë se momenti i parë, kur merr dijeni. Pastaj kuptohet që ti nuk mund të ushtrosh veprime nëse nuk janë në kompetencën tënde. Kështu që biem dakord që të reflektojmë fjalën “iniciativë” te germa “a”, në vend të fjalës “nismë”, pjesa tjetër të mbetet kështu siç është.

Kush është dakord me sugjerimin e bërë, sikurse u relatua? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet edhe neni 5.

Kalojmë te neni 6 i projektligjit, që flet për veprimtarinë me iniciativë në raste të veçanta. Është ajo për të cilën folëm pak më parë. A ka ndonjë ndërhyrje për ndonjë sugjerim për përmbajtjen e këtij neni të projektligji?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Mund të bëjmë një redaktim, duke hequr fjalët “të institucioneve të tjera shtetërore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse është hequr, në rregull.

Ermonela Felaj – Jam dakord. Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 6? Kundër dhe abstenime nuk ka.

Miratohet edhe neni 6.

Kalojmë te neni 6 i projektligjit “Mbikëqyrja dhe varësia e Policisë Gjyqësore”. Ky është edhe titulli i kreut. Kuptohet që Policia Gjyqësore, kjo është theksuar në Kodin e Procedurës Penale, në të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë penale, nuk vepron në mënyrë të pavarur, por veprimtaria e saj drejtohet dhe kontrollohet nga prokurori, i cili edhe në Kushtetutë ka ekskluzivitetin e ngritjes së akuzës publike dhe zhvillimit të hetimeve. Pra, është e qartë pjesa e varësisë.

Neni 7 është ndërtuar me 5 pika, të cilat normojnë në mënyrë të detajuar se cilat janë urdhrat dhe udhëzimet që duhet t’u binden oficerët e seksioneve dhe të shërbimeve gjatë punës së tyre. Grupi i punës ka reflektuar ndryshimet deri në momentet e fundit. A ka ndonjë ndërhyrje për këtë nen?

Kujtim Luli – Te neni 7, pika 6 vazhdimi i fjalisë, aty ku thuhet: “Dhe për koordinimin e veprimtarisë së prokurorëve” duhet të shtohet: “...edhe Policisë Gjyqësore”, sepse nuk ka kuptim fjalia. Veprimtaria e prokurorëve duhet të koordinohet me...

Ermonela Felaj - Më fal, zoti Luli!

Mendoj se pikën 6 të nenit 7 nuk është e nevojshme që ta vendosim këtu. Ky nuk është një ligj për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë ku ne të përcaktojmë se çfarë bën Prokurori i Përgjithshëm. Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme” që është një ligj i cilësuar, ne e kemi thënë qartësisht se çfarë bën Prokurori i Përgjithshëm. Nuk është rasti të marrim një dispozitë të atij ligji dhe ta vendosim në një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë. Unë nuk do të isha për pikën 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është në rregull, se ka të bëjë me punën, ndërsa Prokurori i Përgjithshëm e ka atributin me ligjin e tij, nuk ka nevojë ta thotë ligji “Për Policinë Gjyqësore”. Përgjithësisht

referencat që përdorin ligjet e thjeshta transfuzojnë norma nga ligjet e cilësuara, nuk është një gjë që qëndron, nuk e kemi pranuar. Në fakt, unë nuk do të isha për pikën 6.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Pika 6 është vendosur në momentet e fundit me këmbënguljen e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme. Këtë debat kishim edhe ne, pasi nuk ishte e nevojshme që të shtrihej në këtë ligj. Rëndësi ka që ky ligj të mos bie ndesh me ligjin specifik.

Ermonela Felaj- Edhe po ra ndesh do të zbatohet ai ligj, sepse është i cilësuar.

Elena Xhina – Përderisa ne kemi mundësi, e kemi në dorë, po e shqyrtojmë rëndësi ka që të mos ketë dispozita që bien ndesh. Ka qenë këmbëngulja e përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme që ne kemi vënë atë dispozitë. Të dëgjojmë edhe njëherë sot zotin Luli, se çfarë mendimi ka lidhur me këtë gjë.

Ermonela Felaj - Po, zoti Luli edhe njëherë për pikën 6.

Kujtim Luli – Cila është arsyeja pse ne kemi sugjeruar dhe vazhdojmë të mendojmë se është e nevojshme të jetë në këtë ligj. Oficerët e Policisë Gjyqësore nuk i referohen ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, oficerët e Policisë Gjyqësore referencë të veprimtarisë së tyre do të kenë ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Duke bërë pjesë organike këtë kompetencë që Prokurori i Përgjithshëm ka marrëdhënie me Policinë Gjyqësore, ne e kemi theksuar te veprimtaria dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së saj, që parashikon neni 7 për të bërë të mundur zbatimin e kësaj kompetence të Prokurorit të Përgjithshëm nga shërbimet dhe seksionet e Policisë Gjyqësore në të gjitha strukturat e tyre. Kjo ka qenë e gjithë arsyeja.

Ermonela Felaj - A mund të bëjmë një marrëveshje të tillë? T’i qëndrojmë kësaj arsyeje që thatë pak më parë. Në pikën 2, ku themi: “Policia Gjyqësore zbaton urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit”, të themi: “Policia Gjyqësore zbaton urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, të prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhet të hetohen me përparësi dhe veprimeve konkrete”. Pra, ta fusim këtu, te pika 2. A mundemi ta bëjmë këtë gjë?

Zoti Progonati, si mendoni?

Alfred Progonati - Mendoj se nuk mund të vendoset te kjo pikë. Pika 2 ka të bëjë me çështjet konkrete dhe me urdhrat e prokurorit të çështjes, jo me drejtues të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ermonela Felaj - Në rregull. Po bëj edhe një sugjerim tjetër, që të gjejmë një konsensus me ju. A mund ta bëjmë në këtë mënyrë, duke filluar fjalinë jo Prokurori i Përgjithshëm, por duke thënë: “Policia Gjyqësore zbaton udhëzimet e përgjithshme me

karakter detyrues që nxjerr prokurori i Përgjithshëm”? Kjo të jetë pika 6. Në këtë mënyrë, edhe meraku juaj ezaurohet.

Jemi dakord me këtë formulim të pikës 6 të nenit 7 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nen 7 në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8 “Ruajtja e sekretit hetimor” ose “Ruajtja e sekretit të hetimeve”.

Është një nen i rëndësishëm, duke pasur parasysh fenomenin negativ, ku shpeshherë aktet e dosjeve hetimore dalin në publik, ende pa përfunduar hetimet. A ka ndonjë moment, ku të shprehemi më mirë? Këtë gjë e kam edhe për kolegët e Prokurorisë së Përgjithshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të doja të tërhiqja një mendim, në fakt, nëse është shprehja e duhur shprehja “që cenon normat e moralit”. Ndjesë, por më duket pak si arkaike, të them të drejtën. Nuk është se morali është i vendosur njëherë e mirë, dhe në shoqëri të ndryshme morali nuk është i njëjtë. Ndoshta, më shumë duhet të kujdesemi që të respektohen të drejtat dhe liritë e personit, dinjiteti i personit, se sa të thoshim: “normat e moralit”.

Alfred Progonati – Unë mendoj se është e mjaftueshme thjesht fjalët: “të drejtat kushtetuese”, të hiqet ajo shprehje. Pra: “që shkel të drejtat kushtetuese të personit”, ku përfshihen të gjitha.

Ermonela Felaj – Ose mund të themi: “që cenon nderin, dinjitetin, të drejtat dhe liritë e personit”. Kjo do të ishte më e plotë si shprehje. Shprehjen: “që cenojnë nderin dhe dinjitetin” e kemi, sepse gjithsesi, “veprat penale që cenojnë nderin dhe dinjitetin” i kemi në Kodin Penal.

Në rregull! Atëherë bëjmë një ndërhyrje të pika 2, duke kryer një riformulim dhe në vend të shprehjes “që cenon normat e moralit” të themi: “që cenon nderin, dinjitetin, të drejtat dhe liritë kushtetuese të tij”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, “Liritë dhe të drejtat” shkojnë bashkë, nuk janë e njëjta gjë.

Atëherë, kush është dakord me këtë reflektim të pikës 2 dhe me nenin 8 në tërësi?

Po, faleminderit, kolegë!

Kundër nuk ka. Abstenime nuk ka.

Miratohet edhe ky nen!

Kalojmë te neni 9 i projektligjit: “Komisioni i Policisë Gjyqësore”.

Në fakt, edhe sipas diskutimeve që u mbajtën dhe në parim, realisht është një pikë e rëndësishme e këtij projektligji, sepse në një farë mënyre Komisioni i Policisë Gjyqësore do të jetë si ajo qeveria e vogël e të gjithë oficerëve të Policisë Gjyqësore. Kuptohet se edhe përmbajtja, të drejtat dhe detyrat që do të ketë ky komision, përbërja më shumë se sa përmbajtja, të drejtat dhe detyrat që do të ketë ky komision, si dhe mandati për të vepruar, që do të ketë ky komision, sipas mendimit tim janë shumë të rëndësishme.

Në krahun e majtë keni një propozim fillestar, i cili kërkon që Komisioni i Policisë Gjyqësore të ketë në krye një prokuror, që komandohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ndërkohë, propozimi që vjen nga prokuroria e Përgjithshme, që është reflektuar e mbështetur edhe te grupi i punës, është që ky prokuror të jetë nga seksioni i prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme, i ngarkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Do të doja t'ju bëja me dije, kolegë, në cilësinë e relatores së këtij projektligji, se nuk është rastësi ky opinion i Prokurorisë së Përgjithshme, sepse po të shohim ligjin “Për prokurorinë”, që është ligji 97 i vitit 2016, në nenin 3 të tij thuhet: “Prokuroria drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore”.

Në nenin 38 të ligjit, shprehimisht bëhet fjalë për kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë nen ka disa germa, që i japin atribut të qarta Prokurorit të Përgjithshëm në raport me Policinë Gjyqësore. Aty thuhet: “Prokurori i Përgjithshëm drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore”.

Fillimi i hetimit disiplinor për të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore, është po ashtu një atribut që i takon Prokurorit të Përgjithshëm. Udhëzimet që nxjerr Prokurori i Përgjithshëm në përgjithësi për sistemin, nuk janë thjesht të detyrueshme për prokurorët, por janë të detyrueshme po ashtu edhe për oficerët e Policisë Gjyqësore.

Kështu që, nëse përgjegjësinë për Policinë Gjyqësore ia kemi lënë Prokurorit të Përgjithshëm, kuptohet se në Komisionin e Policisë Gjyqësore duhet të jetë një prokuror, i cili vjen nga Prokuroria e Përgjithshme, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Sepse, normalisht, nuk mund t'ia japim përgjegjësitë në ligj, e pastaj t'ia kërkojmë këto përgjegjësi kur ai nuk ka instrumentet për të ekzekutuar të tilla përgjegjësi në këtë komision. Kësisoj, parimisht, në cilësinë e relatores, unë do të isha me këtë përmbajtje të nenit 9, sikundër është propozuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga grupi i punës.

Nuk e di nëse ka ndonjë qëndrim tjetër nga kolegët.

Po kështu, në lidhje me pikën 3 do të doja të kisha një opinion edhe nga prokurorët, edhe nga kolegët.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Policisë Gjyqësore përcaktohen të kenë një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Unë mendoj se afati dyvjeçar nuk është i mjaftueshëm, që dikush të ndërtojë një punë të qëndrueshme brenda një organi të tillë, siç është ky komision. Në fakt, unë do të isha për një mandat katërvjeçar, duke pasur parasysh edhe mandati i Prokurorit të Përgjithshëm është mandat i shtrirë në kohë, është shtatë vjet si mandat.

Ky është organ kolegjal, në krye ka një prokuror, në përbërje ka oficerë të Policisë Gjyqësore. Pra, përbërja është e larmishme, nuk është se s'e siguron respektimin e të drejtave dhe detyrave që kanë oficerët e Policisë Gjyqësore, por sa i takon mandatin, mandati dyvjeçar i kryetarit dhe i anëtarëve të komisionit më duket i shkurtër. Nuk më duket mandat i mjaftueshëm, aq më tepër se kjo është një punë që bëhet për herë të parë. Ne nuk kemi një traditë apo një përvojë në këtë drejtim. Ka shumë rëndësi ajo çfarë ndërtojmë në momentin e parë. Ndoshta mund të zbrisnim edhe te treshi, por gjithsesi unë jam për më shumë se dy.

Paulin Sterkaj – Me leje!

Ermonela Felaj – Po, zoti Sterkaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E marrim fjalën me radhë.

Paulin Sterkaj – Unë do të thosha se 2 vjet është shumë pak për ta ushtruar detyrën. Minimumi, do ta kisha lënë 5 vjet, sepse ky 2-vjeçari është lënë në dorë të individëve të tjerë, për të parë nëse ka funksionuar ose jo. Për 5 vjet ai krijon autoritetin, personalitetin dhe ngritjen e tij profesionale në marrëdhënie me punën dhe detyrimet që ka. Për 2 vjet, edhe nëse ai mundohet të jetë korrekt dhe në zbatim të çdo ligji, e lënë t'i zbatojë, e largojnë dhe nesër vendosin tjetrin. Për 5 vjet ai krijon autoritet, personalitet, nga ana profesionale është shumë më i pjekur dhe nga ana e gjykimit është më me eksperiencë. Kaq kisha.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Një opinion tjetër nga kolegët dhe pastaj nga...

Paulin Sterkaj – Më fal! Kam edhe diçka tjetër. Një herë ka të drejtë të jetë, apo vetëm 2 vjet ose 5 vjet, sipas këtij projektligji?

Ermonela Felaj – Ai ka të drejtë rizgjedhjeje një herë, po ashtu edhe të gjithë anëtarët. Janë 5 anëtarë dhe një kryetar.

Paulin Sterkaj – Atëherë, minimalja duhet të jetë 5 vjet. Kështu e mendoj unë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Sterkaj është për variantin 5 vjet.

A ka ndonjë qëndrim tjetër nga kolegët e komisionit?

Zonja Xhina, si e mendoni këtë?

Elena Xhina – Sinqerisht, edhe unë jam e mendimit që duhet të jetë më tepër se 2 vjet. Nëse duhet të jetë 3, 4 apo 5 vjet, këtë le ta hedhim në votim. Mendoj që 5 vjet është tepër dhe 2 vjet është pak.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – ...Ne mendojmë që deri sot, kjo edhe sipas akuzave, politika ka futur shumë hundët me këto ndërhyrje. Koha 5 vjet nuk të lejon të jesh as me njërin grup, as me tjetrin. Je i detyruar të mbash të drejtën... Nëse bëhet fjalë për 2 vjet, politika aktuale do të mundohet me mënyrat e saj, me levat saj, se po e shohim se si po bëhen gjërat. Ai nuk do të jetë i pavarur 100%. 5-vjeçari i jep mundësinë atij të jetë i pavarur në komision. Kështu e mendoj unë, qofsha i gabuar!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Dhima ka një mendim.

Antoneta Dhima – Mendoj që afati të jetë 7 vjet, aq sa është afati i prokurorit dhe pa të drejtë rizgjedhjeje.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë opinion tjetër?

Po, zonja Arbi.

Mimoza Arbi –Desha t'ju sqaroj për opinionin dhe se pse është diskutuar kështu në grupin e punës. Ky është një komision *ad hoc*, ku vetëm kryetari, që është prokuror, është me kohë të plotë. Të gjithë këta zgjidhen nga institucionet e emërtesës. Pra, institucionet e emërtesës, referuar kriterëve të përcaktuara në neni 9, bëjnë propozimin për anëtarin e këtij komisioni.

Mbështes sugjerimin e kryetares, që afati 2-vjeçar është i shkurtër. Mandati 4-vjeçar është shumë pozitiv, nëse miratohet, sepse edhe anëtarin, që vjen me rrotacion midis Drejtorisë së Tatimeve dhe Doganave, pavarësisht se ligji këtu ndryshon... Për shembull, kemi dëgjuar që qeveria do të bëjë bashkimin e dy institucioneve. Rrotacioni midis tyre mund të ndikojë që brenda këtij 4-vjeçari edhe ata ta realizojnë rrotacionin e përfaqësimit në komision. Të hiqet e drejta e ripërtëritjes, sepse nëse do të vendoset 4 vjet për të qenë anëtar në këtë komision, atëherë nuk ka se pse të ketë të drejtë ripërtëritjeje, sepse ky është një komision *ad hoc*. Rigjenerimi i këtij komisioni ruan edhe problemet me objektivitetin e gjykimit, sepse duhet të kemi parasysh që këta kanë të drejtë të emërojnë, të komandojnë, të japin opinionin e tyre për transferimet për institucionet e tjera, që ligji i përcakton dhe i jep atributet e Policisë Gjyqësore. Njëkohësisht, merren edhe me trajnimin e tyre dhe me procedimin disiplinor. Pra, kanë shumë

kompetenca të rëndësishme. Ky rifreskim i tyre çdo 4 vjet, duke qenë një komision *ad hoc* nga institucionet e emërtesës, ruan shumë objektivitetin dhe qëndrimin për kompetencat që kanë. Ky është opinionimi dhe diskutimi që është bërë në grupin e punës.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Arbi!

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Edhe unë ndaj të njëjtin opinion me parafolësit, që mandati 2-vjeçar është afat i shkurtër, por për t’i përqasur këtij mandati edhe mandatin e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili e ka 7-vjeçar, mendoj të bëhet me ripërsëritje, me 3 vjet, që të jenë brenda mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, të paktën, nëse Prokurori i Përgjithshëm vlerëson se drejtuesi i komisionit, i ngarkuar prej tij, është i domosdoshëm, ta vazhdojë veprimtarinë në këtë komision dhe për shkak të qëndrueshmërisë së këtij komisioni ai do ta mbajë 3 vjet dhe do t’i japë edhe një mandat tjetër. Nëse ai konstaton se komisioni nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet dhe ka nevojë të freskohet, në mënyrë që të mos ketë kohë të gjatë qëndrimi, bën një rinovim për të përmirësuar cilësinë e punës dhe performancën e komisionit brenda mandatit të tij.

Ermonela Felaj – Faleminderit, për të gjitha kontributet!

Po, zoti Progonati.

Alfred Progonati – Lidhur me afatin, jam dakord qoftë me 4 vjet, qoftë me 3 vjet, por unë do ta shtroja diçka lidhur me përbërjen e komisionit. Duke u nisur nga kompetencat që ligji i jep Prokurorit të Përgjithshëm në fushën e ushtrimit të ndjekjes penale dhe për Policinë Gjyqësore (këtu thuhet: “Mbikëqyr, kontrollon dhe bashkërendon punën”), më duket se është balancuar ky përkufizim në komision, duke e kaluar balancën me 3 anëtarë nga Policia Gjyqësore, që janë jashtë sistemit të prokurorisë dhe 2 nga prokuroria. Pra, në një kohë që ne i ngarkojmë Prokurorit të Përgjithshëm përgjegjësi të përgjigjet për punën e Policisë Gjyqësore, ajo nuk ka kompetenca lidhur me rekrutimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore për prokurorinë. Kjo shihet edhe në nenin më pas, kurse Policia e Shtetit i bën vetë emërimet në Policinë Gjyqësore dhe Prokurorit të Përgjithshëm i kërkohet t’i kalojë në komision.

Ermonela Felaj – Në rregull!

Unë mendoj se tek ai nen mund të reflektojmë një ndryshim, sepse ka diçka që nuk shkon sipas atij formulimi, por këtë gjë do ta diskutojmë më pas.

Cili është qëndrimi juaj për momentin aktual? Pra, a duhet zgjatur mandati i kryetarit?

Alfred Progonati – Po, patjetër duhet zgjatur mandati i kryetarit.

Ermonela Felaj - Duhet të kenë të drejtë rizgjedhjeje apo nuk duhet të kenë të drejtë rizgjedhjeje kryetari dhe anëtarët bashkë?

Alfred Progonati – Nuk ka problem për momentin, sepse edhe sikur ta lemë afatin 4 vjet, edhe sikur të ketë të drejtë rizgjedhjeje, nuk sjell ndonjë pasojë.

Ermonela Felaj- Atëherë unë shikoj se mendimet përkojnë në një pikë që mandati patjetër që duhet të zgjatet. Ndërkohë, ne kemi një ndarje të qëndrimeve për sa i takon të drejtës për t'u rizgjedhur, apo jo. Unë dua të shtoj një argument të zgjatja e mandatit, që afati i përgjithshëm i hetimeve është dy vjet. Le të mendojmë pak se çfarë llogarie do t'i kërkonte ky komision Policisë Gjyqësore për ndjekjen e hetimeve në momentin që mandati i tij do ta kishte dy vjet. Pra, do t'i bëhej puna e pamundur. Unë besoj se ata nuk do të dilnin dot në konkluzione në hetimet e vështira, të cilat kërkojnë kohë, sigurisht nëse hetimi është ndjekur sipas dispozitave që ka Kodi i Procedurës Penale. Kështu që, argumenti shtesë është se ky afat absolutisht duhet zgjatur.

Atëherë, unë dua t'u sugjeroj kolegëve që të mos ndaleshim konkretisht tek afatet. Meqenëse ne jemi komision për dhënie mendimi, dua që t'i sugjerojmë Komisionit të Ligjeve për pikën 2 të këtij neni, që afati të zgjatet në 4 apo 5 vjet, siç propozoi zoti Sterkaj, dhe të kenë të drejtë rizgjedhjeje. Pika më e rëndësishme për ne është mandati, dhe është më pak e rëndësishme nëse kanë apo jo të drejtë rizgjedhjeje, sepse kjo është një e drejtë, që nuk vjen automatikisht, por do ta vendosin të tjerët. Kështu që mua nuk më duket se kjo pjesë na prish ndonjë punë.

Atëherë, votojmë pikën 3 me ndërhyrjen për mandatin që duhet të jetë më i gjatë, 4 ose 5 vjet, por gjithsesi duhet të jetë brenda mandatit që ka Prokurori i Përgjithshëm. Unë nuk besoj se ka ndonjë vërejtje tjetër për këtë nen.

Kush është dakord me nenin 9 të projektit, sipas të gjitha diskutimeve që ne bëmë për pikat e tij? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 10, ashtu siç e ka sjellë grupi i punës, i cili bën fjalë për kompetencat që ka komisioni i Policisë Gjyqësore. Për lehtësi ne mund t'i marrim me radhë pikat, por në qoftë se koleget kanë diçka për të shënuar për secilën nga pikat, ju lutem, më thoni. Pra, ky është komisioni, i cili do të ketë të drejtë të përcaktojë numrin e përgjithshëm të oficerëve të seksioneve në shërbime. Natyrisht, këtë atribut nuk do ta ushtrojë vetëm, por në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm. Kjo do të jetë në të njëjtën kohë edhe njësia, e cila do të vendosë për emërimin, për ngritjen në detyrë, për transferimin, si dhe për komandimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore.

Dje në komision u bë një pyetje se cila është karriera e një oficeri të Policisë Gjyqësore. Sikurse parashikohet në projekt dhe në përkufizime, ngritja në karrierë nënkupton

kalimin e tij nga shkalla e parë në Prokurori të Përgjithshme. Ky është i vetmi moment nëse mund të shënohet si i tillë. Kërkesat për procedime disiplinore, që vijnë nga Prokurori i përgjithshëm, i shqyrton ky komision. Gjithashtu, shqyrton edhe rezultatet e punës për çdo oficer të Policisë Gjyqësore, integritetin e tyre, po ashtu edhe për trajnimet, që janë aq të domosdoshme, ky komision do të ketë përgjegjësitë e tij. Pra, nuk shikoj të ketë ndonjë sugjerim të ndryshëm.

Atëherë, kush është dakord me nenin 10 të projektit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Ne e dimë shumë mirë që miratohet neni 10, sikurse është propozuar nga grupi i punës.

Neni 11, “Organizimi dhe funksionimi i komisionit të Policisë Gjyqësore”, i cili ka të bëjë me procedurën e punës që do të ndjekë komisioni, sapo të konstituohet.

A ka ndonjë koment?

Po, zoti Progonati.

Alfred Progonati – Te pika 5 e nenit 11, lidhur me sekretarinë teknike, ku ngarkohet administrata e Prokurorisë së Përgjithshme, ndoshta duhet një parashikim më i hollësishëm se çfarë detyrash duhet të kryejë komisioni. Nuk e di se sa ka mundësi Prokuroria e Përgjithshme të ofrojë një sekretari teknike të efektshme, sepse, me sa shikoj, ka për të kryer shumë detyra.

Gjithashtu, duhet zgjidhur edhe problemi i administrimit të dosjeve për ata që kërkojnë transferim. Këto dosje duhet të shkojnë në Prokurori të Përgjithshme apo do t’i mbajë policia? Kjo duhet sqaruar, sepse nuk është e sqaruar. Ndoshta duhet një riformulim më i saktë.

Ermonela Felaj – A keni ju ndonjë formulim?

Alfred Progonati – Jo, nuk kam, por më tërhoqi vëmendjen.

Ermonela Felaj – Në fakt, më bën sens.

Këshilltari i komisionit më thotë që në pikën 6 thuhet: “Rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisionit të Policisë Gjyqësore, përbërja dhe detyrat e sekretariatit teknik përcaktohen në rregulloren e brendshme, që miratohet nga vetë komisioni”. A mendoni se kjo e ezauron shqetësimin tuaj, që komisioni do të përcaktojë rregullat e punës?

Alfred Progonati – Për mua nuk e ezauron, sepse ku do t’i gjejë burimet komisioni? Në një pikë thuhet: “Përcaktohet Prokuroria e Përgjithshme”, por a është e gatshme prokuroria t’i përgjigjet një rregulloreje të komisionit? Ndoshta duhet bërë një formulim më detyrues për prokurorinë, pra të detyrohet që të bëjë edhe këtë.

Ermonela Felaj – Po, zonja Arbi.

Mimoza Arbi – Vetë dispozita përcakton që sekretariati teknik do të jetë staf administrativ nga Prokuroria e Përgjithshme. Pra, vetë formulimi i dispozitës i lë detyrim Prokurorit të Përgjithshëm që pranë këtij komisioni të caktojë nga shërbimi i administratës një numër të caktuar personeli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Edhe unë mendoj që në kuptim të detyrimeve për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, i jep Prokurorit të Përgjithshëm edhe këtë përgjegjësi, pra evidentohet dhe është e shkruar në ligj. Pse? Sepse aty thuhet: “Përveçse kontrollon dhe drejton veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, bashkërendon edhe punën”. Pra, Prokurori i Përgjithshëm e ka detyrimin, ndoshta jo fjalë për fjalë, por e ka edhe për shkak të këtij ligji. Në momentin që komisioni do të kërkojë sekretari teknike dhe të tjera asistencë të nevojshme, që i disponon Prokurori i Përgjithshëm, ai detyrohet t’i përgjigjet.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Edhe unë jam dakord me analizën dhe komentet që bëhen rreth kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm, pra edhe sipas nenit 38, i cili ka detyrimin të koordinojë, të bashkërendojë dhe të mbikëqyrë veprimtarinë, por edhe për shkak të pozicionit që merr me përfaqësuesin e tij në komision, si drejtues i këtij komisioni për ta krijuar këtë mundësi në realizimin e kompetencave të tij.

Problemi që lidhet me buxhetin dhe resurset është i lidhur me motivimin në kërkesat e tij për buxhet në zbatim të këtyre detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Dhima, shikoj se keni një diskutim me zotin Vorpsi.

Antoneta Dhima – Ne kemi një diskutim për pikën 4, ku thuhet: “Komisioni vendos me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm me votim të hapur. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetari është përcaktuese”. Po në rastin kur janë katër anëtarë dhe raporti është 2 me 1, vota e kryetarit anon nga 1 dhe votimi del barazim, çfarë vendimmarrje do të ketë?

Ermonela Felaj – Është organ kolegjal dhe, duke qenë i tillë, kryetari ka gjithmonë votën dyshe.

Antoneta Dhima – Po, por duhet të sqarohet.

Ermonela Felaj – Nuk ka nevojë të sqarohet, sepse është te ligji i organeve kolegiale.

Ndërsa për pikën 5 që po diskutojmë, dua t’ju siguroj që, kur të vijmë te dispozitat tranzitore të ligjit, ne mund të kujdesemi që ta shprehim detyrimin e Prokurorit të Përgjithshëm që të asistojë komisionin e Policisë Gjyqësore dhe të heqim çdo merak. Ashtu siç ngarkojmë

Këshillin e Ministrave për çdo lloj ligji me detyrimin që për 1,2 dhe 3 gjëra të nxjerrë VKM, mundemi ta bëjmë këtë edhe për Prokurorin e Përgjithshëm.

Alfred Progonati – Unë nuk e vë në dyshim gatishmërinë e Prokurorisë së Përgjithshme, por unë e kam më shumë të burimet që ka aktualisht. Ne pretendojmë që do të miratohet ligji dhe do të fillojë zbatimi i tij, por aktualisht prokuroria nuk ka staf. Prandaj po them që duhet parë me kujdes, sepse ne nuk kemi staf për veten tonë dhe shkruajmë çdo gjë vetë.

Ermonela Felaj – Dakord, por si fillim ndryshuam trajtimin financiar për të gjithë.

Besoj se nuk kemi ndonjë diskutim tjetër për nenin 11?

Kush është dakord me nenin 11, sipas propozimit që ka sjellë grupi i punës? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12 “Organizimi i Policisë Gjyqësore”, i cili flet për shërbimet e Policisë Gjyqësore.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13, që bën fjalë për seksionet e Policisë Gjyqësore, të cilat ngrihen pranë çdo prokurorie, janë të përbëra nga juristë dhe që është e domosdoshme, sepse hetimi nuk mund të kryhet nga oficerët e shërbimeve dhe agjentët, pasi kallëzimet që vijnë janë të natyrave të ndryshme, janë kallëzime që mund të vijnë nga radhët e Policisë së Shtetit dhe ajo nuk mund të hetojë vetveten ose kallëzime që vijnë nga organe të tjera, si për shembull, KLSH-ja, që bën shpesh kallëzime në prokurori. Kjo kërkon një qasje dhe formim tjetër ndaj Kodit të Procedurës Penale, kështu që unë nuk do ta vija absolutisht në diskutim ekzistencën e seksioneve të Policisë Gjyqësore. Pra, seksionet janë të domosdoshme, duhet të kemi një fokus të veçantë që ata të specializohen gjithnjë e më tepër dhe të mund të marrin më ekselentët. Po ashtu janë edhe një mundësi për punësimin e të gjithë atyre të rinjve, të cilët nuk zgjedhin të bëhen as gjyqtarë, as prokurorë, as avokatë, as noterë.

Kujtim Luli –Në paragrafin e parë parashikohen seksione pranë prokurorive të Gjykatës së Shkallës së Parë. Ajo që ndjehet e nevojshme në praktikën e veprimtarisë së Prokurorive të Apelit është të ketë oficerë të seksioneve për të kryer detyrat e ngarkuara me urdhrat e prokurorëve, por edhe të Gjykatave të Apelit në ekzekutimin e vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm, por edhe të urdhërimeve të tjera që lidhen me njoftimet për sjelljet me detyrim. Këta oficerë pranë seksioneve në vlerësimin tonë janë të nevojshëm të vendosen që të krijojnë lirësi në veprimtarinë e gjykatave.

Ermonela Felaj - Unë, në fakt, kam merakun e një gjëje që është shumë praktike, sipas asaj që unë kam parë prokuroritë e Apeleve dhe gjykatat i drejtohen shkallës së parë, sepse ata që janë në shkallën e parë kanë të gjitha kontaktet dhe njohjet me çështjen, ndërsa oficeri i Prokurorisë së Apelit nuk ka marrë pjesë në hetimin e çështjes dhe di adresën e deklaruesit, di adresën e personit në hetim, ose di të tjera hollësi të ngjarjes, kështu që për praktikitet dhe për të fituar kohë gjykatat veprojnë më së shumti me gjykatat e shkallës së parë. Nuk e di sa të nevojshme e keni që të kemi oficerë në Prokuroritë e Apeleve.

Kujtim Luli- Referuar neneve 462 dhe 466 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohen vendimet me ekzekutim të menjëhershëm. Atëherë, si mund t'i drejtohet në orën 16:00 kur shpall vendimin gjykata për ekzekutimin e këtij vendimi një shërbimi tjetër jashtë Prokurorisë së Apelit? Prokurori del nga seanca gjyqësore dhe nxjerr urdhrin për ekzekutimin e atij vendimi, kujt do t'ia japë për ekzekutim kur orari zyrtar është mbyllur. Kështu që kjo krijon vështirësi për ta mundësuar ekzekutimin e menjëhershëm?

Mimoza Arbi – Shqetësimi i zotit Luli është diskutuar nga grupi i punës, por në frymën e këtyre dispozitave, urdhrin e ekzekutimit e nxjerr prokurori dhe nuk është kompetencë e oficerit të Policisë Gjyqësore. Ky urdhër i ekzekutimit çohet për t'u ekzekutuar, referuar mjeteve të komunikimit, dhe për këtë arsye, në frymën e këtyre dispozitave, është diskutuar që të mos bëhet fjalë për oficerë të Policisë Gjyqësore në Apel, pasi prokuroritë e Apelit kanë të drejtën e përfaqësimit të tyre në gjykimet në apel, por jo të kryerjes së veprimeve hetimore. Oficeri i Policisë Gjyqësore kryen veprime hetimore dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kryerje të veprimeve hetimore. Urdhri i ekzekutimit është kompetencë ekskluzive vetëm e prokurorit. Ky është qëndrimi i grupit të punës dhe për këtë arsye nuk është përmendur oficeri i Policisë Gjyqësore të Apelit.

Ermonela Felaj – Po, zoti Progonati.

Alfred Progonati – Në këtë kuadër të kërkojmë sa më shumë në fakt, por nuk do të ishte keq të kishte edhe një oficer policie në çdo apel pikërisht për të bërë ato detyra që thotë edhe Kujtimi. Ne e kemi si praktikë që për vendimet e Gjykatës së Lartë, kemi një oficer policie në Prokurorinë e Përgjithshme, i cili merret me ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve që jep Gjykata e Lartë kur urdhëron lirim të menjëhershëm. Kjo nuk kërkon kosto në qoftë se ju e parashikoni, sepse edhe ne duhet ta kemi një punonjës në Apel së bashku me 2-3 oficerë.

Ermonela Felaj – Aktualisht sa oficerë ka në Prokurorinë e Apelit?

Alfred Progonati – Aktualisht janë 7, sepse çdo Prokurori e Apelit ka një oficer të vetin.

(Diskutime pa mikrofon)

Emrin më pas mund ta zgjidhim.

Ermonela Felaj – Meqenëse numri i oficerëve nuk është i lartë është më mirë ta çlirojmë nga pengesat sesa të na krijohet një pengesë në të ardhmen, prandaj do të isha pro idesë për shtimin e oficerëve në Prokuroritë e Apelit, pasi nuk kërkohen ndonjë numër i madh njerëzish. Gjithsesi, kjo është një shpërndarje që komisioni do ta bëjë për çdo prokurori.

Oficerë policie, por që do të jenë aty për të kryer këto veprime.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është se kemi ndryshuar ndonjë gjë se seksionet dhe shërbimet i kemi edhe tani...

(Diskutime pa mikrofon)

Po, me një oficer, sepse ka seksione edhe me një prokuror...

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo praktikë ekziston, apo jo?

Alfred Progonati – Kjo praktikë ka ekzistuar. Pra, nuk duhet të emërohet nënseksioni, por oficer policie pranë Prokurorisë së Apelit, sepse ky është urdhri i emërimit.

Ermonela Felaj – Kolegë, kush është dakord që t'i sugjerojmë Komisionit të Ligjeve që në pikën 1 të nenit 13 që bën fjalë për seksionet e Policisë Gjyqësore, të shtohen në përmbajtje edhe Prokuroritë e Apeleve?

Pra, të jetë i formuluar në këtë mënyrë: “Seksionet e Policisë Gjyqësore krijohen në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm, Prokuroritë e Apeleve dhe në Prokurorinë e Përgjithshme”. Pra, në të gjithë sistemin.

Kujtim Luli – Unë mendoj të jetë në këtë mënyrë: “Pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatave të Apeleve të juridiksionit të përgjithshëm”.

Ermonela Felaj – Edhe mënyra si e thatë ju bën sens.

Besoj se nuk ka ndonjë kundërshti thelbësore për këtë pikë. Kush është dakord me sugjerimin e bërë që ne t'ia propozojmë në mënyrën që u diskutua këtu Komisionit të Ligjeve përmbajtjen e nenit 13? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Kalojmë te neni 14 “Organizimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore”.

A ka mendime nga kolegët për këtë nen? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 14 të projektit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 15 “Organizimi i seksionit të Policisë Gjyqësore”, i cili është neni që sapo mbyllëm, neni 13, që bën fjalë se ku organizohen seksionet e Policisë Gjyqësore.

Neve na duhet që Prokurorinë e Apelit ta referojmë edhe te pika 1, por mund ta bëjmë edhe në mënyrë të thjeshtë, duke thënë: “Seksionet e Policisë gjyqësore organizohen në përputhje me strukturën e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”. Në ligjin për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë ne e kemi se si organizohet prokuroria, Prokuroria e Shkallës së Parë, e Apeleve dhe Prokuroria e Përgjithshme, por është përfshirë edhe Prokuroria e Posaçme.

A jeni dakord që propozimi që bëmë pak më parë ta reflektojmë te pika 1 e nenit 15 dhe t’ia propozojmë këtë gjë edhe Komisionit të Ligjeve që ta vendosë përfundimisht?

Kush është dakord me nenin 15?

Miratohet neni 15 i projektit.

Kalojmë te neni 16 “Kriteret e përzgjedhjes së oficerit të shërbimeve të Policisë Gjyqësore”.

Pra, që një oficer policie të mund të punojnë te shërbimet e Policisë Gjyqësore duhet të ketë 5 vjet përvojë pune në institucionin e emërtesës, të ketë përfunduar trajnimin fillestar për hetimin, të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepr penale, të mos jetë në procedim penal apo në gjykim për një vepër penale, të mos ketë marrë disiplinore ose të mos ketë filluar procedim disiplinor, të ketë cilësi të larta etike dhe morale.

Parimisht do të isha që te germa “c” të mos thuhet “të mos jetë nën procedim penal”, por të thuhet “të mos jetë nën hetim apo gjykim”, sepse nuk mund të themi “në procedim penal” nuk është shprehje korrekte.

Te germa “d” do të isha që në vend të shprehjes “të ketë cilësi të larta morale dhe etike” të themi “të ketë integritet”.

Paulin Sterkaj – Ajo është subjektive...

Ermonela Felaj – Po ato subjektive janë.

Paulin Sterkaj – Unë nuk e kuptoj se çfarë do të thotë “cilësi morale”?

Ermonela Felaj – Prandaj po jua them...

Paulin Sterkaj - Këtu jemi në kuadrin e të drejtave të njeriut dikush mendon ndryshe.

Ermonela Felaj – Është më moderne shprehja “të ketë integritet”, Paolo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Integritetin ose e ke, ose nuk e ke. Më shumë se kaq nuk ka.

Ka ndonjë vërejtje tjetër për këtë pjesë?

Urdhëroni, zonja Arbi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, me mikrofon!

Mimoza Arbi – Kam bërë një saktësim te pika 2, sepse meqë këto janë kriteret për oficerët e Shërbimit të Policisë Gjyqësore, kur bëhet fjalë për oficerët e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, ne nuk mund të vëmë kriterin e vjetërsisë në punë 5 vjet. Pra, te pika 2 veç shkronjës “b”, pra trajnimin fillestar sepse oficerët e Policisë së Shtetit e kanë këtë, kemi shtuar dhe përjashtimin e pikës “a”, pra 5-vjetshin si përvojë.

Ermonela Felaj – Të dyja këto janë.

Mimoza Arbi – Dakord.

Ermonela Felaj – Parashikimi i paragrafit 1, shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni, nuk zbatohen për përzgjedhjen e oficerëve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit. Kjo është.

Ka ndonjë sugjerim tjetër? Nuk ka.

Atëherë, te neni 16 germa “c” shprehja “të mos jetë në procedim penal” do të bëhet “të mos jetë në hetim” dhe jo “nën hetim”, se u habitëm me këto “nën”.

Te germa “d” të vihet togfjalëshi: “të ketë integritet”.

Kush është dakord me nenin 16 me këto propozime?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Faleminderit, kolegë!

Kalojmë te neni 17, “Kriteret e përzgjedhjes së oficerëve të Policisë Gjyqësore, seksionet”

Pak a shumë, janë të njëjtat kriteret. Edhe këtu duhet të reflektojmë të njëjtën gjë, të mos jetë nën hetim dhe të ketë integritet. Pra, shkojmë sipas të njëjtës logjikë. Edhe me ndryshimet e nenit 17...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vërejtjet kanë afatet e tyre të parashkrimit. Në qoftë se ajo është parashkruar, ai nuk konsiderohet që e ka masën disiplinore. Në qoftë se nuk është parashkruar, sigurisht e ka masën dhe nuk mund të jetë aty.

Ai do të punojë si punonjës i Policisë së Shtetit, por nuk mund të marrë si punonjës ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, se është për seksionet! Është e njëjta gjë si logjikë. Nuk mund të punojë aty nëse ka procedim disiplinor. Ai mund të ketë qenë jurist në një institucion shtetëror...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk i është parashkruar dhe në momentin që nuk është parashkruar vërejtja, nuk mund të bëhet dot pjesë e trupës së Policisë Gjyqësore të prokurorive. Kjo është ideja. Këto qëndrime ne i kemi vendosur kudo në përgjithësi dhe janë si barriera, që nuk lejojnë që personat me rekorde në figurë të mund të hyjnë në hetim.

Kush është dakord me nenin 17 me këto propozime? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 16.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 18, “Procedura e përzgjedhjes për oficerët e Policisë Gjyqësore”. Bëhet fjalë fillimisht për mënyrën se si zgjidhen oficerët e seksioneve, pra ata që punojnë në prokurori. Ligji parashikon që ata të përzgjidhen nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent konkurrimi dhe në pikën 2 të këtij neni thuhet, që Prokurori i Përgjithshëm pasi mbaron procedura e përzgjedhjes dhe pasi merr opinionin e drejtuesit të prokurorisë përkatëse, përzgjedh kandidaturat më të përshtatshme dhe ia propozon komisionit të Policisë Gjyqësore për emërim. Ka ndonjë vërejtje për këtë pjesë?

Rregullat se si këta do të konkurrojnë do të përcaktohen me propozim të komisionit dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm. Unë di që Prokuroria e Përgjithshme ka një përvojë për këtë pjesë, sepse të paktën vitet e fundit të gjithë oficerët janë testuar me shkrim dhe me gojë dhe besoj se ka një praktikë të konsoliduar dhe të njohur, që me përmirësime të vogla, mund ta adaptoni edhe në këtë rast.

Ka ndonjë vërejtje tjetër për nenin 18? Nuk shoh të keni ndonjë vërejtje.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 18.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 19, “Heqja dorë dhe zëvendësimi”. Ky është një nen i thjeshtë dhe deklarativ, i cili i referohet Kodit të Procedurës Penale për të gjitha rastet kur oficerët kanë detyrimin të heqin dorë ose kur lind detyrimi që ata të zëvendësohen.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 19.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 20, që bën fjalë për ngritjen në detyrë. Natyrisht, oficeri i Policisë Gjyqësore ngrihet në detyrë vetëm mbasi ka bërë 10 vjet punë. Vetëm atëherë komisioni i Policisë Gjyqësore e ngre në detyrë”. Unë nuk e di, por ky afati dhjetëvjeçar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...është shumë apo pak. Për këtë aspekt ju ftoj që ta diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëj këtë tërheqje vëmendjeje për një arsye shumë të thjeshtë, pasi u punësua te Byroja Kombëtare e Hetimit me një vit përvojë, ndërkohë që për t'u ngritur në detyrë nevojiten dhjetë vjet. Më duket disproporcionale në këtë drejtim.

Fjalën e ka zonja Arbi.

(Zonja Arbi e fillon fjalën e saj pa mikrofon.)

Mimoza Arbi – ...duke qenë se ngritja në karrierë është vetëm lëvizja nga një prokurori e Shkallës së Parë në Prokurorinë e Përgjithshme, pra lëviz vetëm niveli i pagës. Natyrisht, duhet përvojë për të kaluar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe prandaj lidhet përvoja në punë me dërgimin në një pozicion ku merr një pagë më të lartë.

Kështu është parë nga grupi i punës, por nuk është parë ndonjë kriter tjetër, sepse ngritja në detyrë është thjesht lëvizja nga njëri institucion në tjetrin, ndërkohë që funksioni dhe detyrat do të jenë të njëjta.

Ermonela Felaj – Vetëm një herë në jetë.

(Ilaritet në sallë)

Mimoza Arbi – Ndërsa për të konkurruar në Byronë Kombëtare të Hetimit të gjithë oficerët e Policisë Gjyqësore e kanë këtë të drejtë dhe, referuar ligjit përkatës, në qoftë se plotësojnë kriteret, ata mund të bëhen oficerë pranë Byrosë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Është edhe për një arsye tjetër, sepse numri është shumë i reduktuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç e thamë, shtatë veta mund të shkojnë në Apel, ndërkohë që një numër më i kufizuar ose rreth këtij numri mund të shkojë edhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga armata e oficerëve të Policisë Gjyqësore duhen përzgjedhur...

Ermonela Felaj – Më të mirët.

Kujtim Luli – ...një numër shumë i kufizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Atëherë, shoh që duhet të mbetemi tek afati dhjetëvjeçar. Kush është dakord me nenin 20, siç është propozuar nga grupi i punës?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 21 “Komandimi”. Ka vërejtje nga përfaqësuesit e prokurorisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është rasti kur, për nevojat e hetimit, një oficer i Policisë Gjyqësore komandohet në një prokurori tjetër ose në një çështje të caktuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se është okej. Periudhat janë tremujore dhe gjashtëmujore brenda një viti kalendarik. Këto janë afatet maksimale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kush është dakord me nenin 21 të projektligjit?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe neni 21.

Vijojmë me nenin 22, që ka të bëjë me transferimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Këtu janë përmendur të gjitha rastet kur mund të ndodhë transferimi: për shkak të ndryshimeve strukturore që pësojnë seksionet ose shërbimet, ose me kërkesë të oficerit të Policisë Gjyqësore drejtuar, sipas rastit, Prokurorit të Përgjithshëm ose titullarit të emërtesës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendoni se kërkesën duhet t’ia drejtojë Prokurorit të Përgjithshëm, apo komisionit të Policisë Gjyqësore, që vendos për transferimet? Këtë pyetje e kam edhe për kolegët dhe për të ftuarit.

Rast tjetër kur një oficer i Policisë Gjyqësore ruan përsëri të drejtën për t’u transferuar është kur ka një situatë reale rreziku ndaj tij për jetën dhe shëndetin e tij ose edhe të familjes, ose kur duhet të shmanget situata..., dhe këtu kemi përsëri fjalën “e papajtueshmërisë etike”, që ne e hoqëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është përmendur dy herë në germën “d” të nenit 22, por vazhdon të përmendet edhe në pikën 2 të këtij neni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thuhet: “Transferimi për shkak të papajtueshmërisë ka përparësi ndaj lëvizjeve paralele”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Transferimi propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm ose nga titullari i institucionit sipas rastit”, ndërkohë që nuk është përfunduar fjalja se ku bëhet ky propozim. Në qoftë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, duhet vënë fjalët “në komision”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta lëmë që t’i drejtohet drejtpërdrejt komisionit? Ndoshta jo, sepse kemi edhe oficerët e shërbimeve, që nuk i drejtohen dot drejtpërdrejt komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, urdhëroni.

Mimoza Arbi – Është lënë, sepse transferimi vërtet do të bëhet nga institucioni i emërtesës, por mendimi do t’i merret komisionit. Pra, në qoftë se komisioni konstaton që ky oficer i Policisë Gjyqësore, qoftë i seksionit, qoftë i shërbimit, ka një çështje, e cila duhet të përfundojë, merr opinionin e prokurorit të çështjes që kjo çështje duhet të përfundojë nga ky oficer dhe nuk do ta miratojë transferimin pa përfunduar çështja. Pra, komisioni është në kuadrin e rregullatorit për komandimet dhe transferimet, që bëjnë institucionet e emërtesës. Për këtë arsye është bërë ky formulim.

Paulin Sterkaj – Me leje?

Ermonela Felaj – Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Pse duhet t’i bëjmë kaq të vështira gjërat? Ne kemi votuar një prokuror të Përgjithshëm për shtatë vjet. Nuk paska asnjë kompetencë ai? Kush është ky që është bërë prokuror i Përgjithshëm, njeri që ta shohim me dyshim, apo ta lëmë në komision dhe të ketë një burokraci të tejskajshme për të mos realizuar asnjë transferim kur është e nevojshme? Kryetarja e komisionit tha që nëse ka një kanosje apo trysni duhet të transferohet nga Tirana në Sarandë apo qytet tjetër. Pse duhet të lamë në njëqind duar?

Prokurori i Përgjithshëm është person i votuar. Edhe atij duhet t’i japim në një farë mënyre kompetenca të plota për t’i gjykuar këto gjëra. Ai që nuk mbron “racën” e vet mendoj që nuk bën as për prokuror të Përgjithshëm. Unë mendoj që prokurori i Përgjithshëm e ka pjekurinë për të analizuar çdo lloj çështjeje pa kaluar në komision. Si do të përgjigjemi ne kur të ndodh dëmtimi i individit? Si ndodhi grabitja në Rinas. E ka fajin koncesionari, policia, apo policia private? Paratë ikën, personi u vra. Kush e zgjidh këtë fenomen? Pse duhet t’i lëmë gjërat në kufij që të mos ketë mundësi zgjidhjeje. Për shembull, komisioni nuk do që ta kalojë? Do të lëvizin oficerë të Policisë Gjyqësore që janë vartës të drejtpërdrejtë të tij dhe në komision e ka autoritetin më të madh sesa të tjerët. Kështu që, unë mendoj t’ia lëmë prokurorit të përgjithshëm lëvizjen për arsye të ndryshme.

Faleminderit.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Po, zoti Luli!

Kujtim Luli - Unë jam shumë dakord me arsyetimet që bëhen për të thjeshtëzuar mundësitë e lëvizjes në rastet emergjente, por kuptimi i këtij neni, në vlerësimin tim, nuk është për prokurorin e Përgjithshëm, por për shërbimet dhe transferimet, që kanë qenë gangrena e shërbimeve të Policisë Gjyqësore, e oficerëve të Policisë Gjyqësore të ngarkuar me çështje nga një rreth në një rreth tjetër. Ky komision do të vlerësoj nëse shkaqet për transferim janë të motivuara ose jo, si dhe do të pengojë transferimet kur ato dëmtojnë veprimtarinë hetimore për të cilën ai është ngarkuar në ushtrimin e funksionit të tij si oficer i Policisë Gjyqësore.

Ermonela Felaj – Faleminderit për opinionin, por mendoj se sensibiliteti që pati zoti Sterkaj nuk lidhet me situatën që ju referuat. Kur dikujt i vihet jeta në rrezik, qoftë ky punonjës i shërbimeve apo i seksionit, procedura e të marrit një vendim për transferimin e tij nuk duhet të jetë burokratike, të kalojë në disa hallka, të kalojë në vendimmarrje, arrihet shumica apo jo.

Mendoj të ndalemi te neni 22 dhe ta organizojmë në dy pjesë. Në rastin e ndryshimeve strukturore, e papajtueshmërive apo rastet që përjashtohen komplet situatat që lidhen me rrezikimin e jetës së punonjësve të Policisë Gjyqësore vendimmarrja le të jetë sipas rutinës së propozuar, kurse në rastet ekstreme ne duhet ta shmangim këtë gjë.

Meqenëse e thamë që në fillim të mbledhjes që nuk do t'i shkonim dot deri në fund sot projektit, mendoj që ta ndalim diskutimin këtu. Ditën e hënë që do ta mbyllim votimin nën për nen, por edhe votimin në tërësi për këtë projektligj, të mendojmë se si mund ta organizojmë më mirë nenin 22 për të shprehur edhe atë që ju me të drejtë thatë në komision. Jeni dakord që ta ndërpresim këtu diskutimin? Ndërkohë, të kemi edhe një variant të propozuar nga ju për nenin 22. Po kështu, nëse ka gjëra të tjera për të reflektuar në pjesën tjetër të projektit, kemi kaluar më shumë se gjysmën, mundësisht t'i kemi edhe me shkrim dhe të jemi më preciz.

Faleminderit të gjithëve për prezencën dhe diskutimet tuaja!

Doja t'ju njoftoja që sot në orën 12:00 do të mbledhet Konferenca e Kryetarëve. Komisioni i Sigurisë duhet të miratojë dy projekte, për të cilat është komision përgjegjës dhe janë parashikuar të jenë pjesë e rendit të ditës të seancës që do të zhvillohet të enjten e ardhshme. Kështu që, do t'ju njoftoj për mbledhje komisioni ditën e premte, në mënyrë që javën e ardhshme të mbyllim ligjin “Për Policinë Gjyqësore” dhe një nga projektet. Brenda ditës së martë jemi të detyruar t'i mbyllim, sepse nuk na e lejon Rregullorja më tej. Sidoqoftë do të ngelemi në kontakt për këtë pjesë.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!